



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM  
Nr.376, datë 30.11.2023

PËR  
“MIRATIMIN E OPINIONEVE PËR KANDIDATËT QË KANË APLIKUAR NË  
PROCEDURËN E KOMANDIMIT SI NDIHMËSMAGJISTRAT PRANË  
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 53, pikat 1 dhe 2 dhe nenin 54 pikat 1, 2 dhe 3, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2 dhe 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, me propozim të Komisionit tër Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e opinioneve për prokurorët Aida Cakaj, Alma Bramo dhe Ervisa Hyka, kandidatë për t’u komanduar si ndihmësmagjistratë pranë Prokurorisë së Përgjithshme.
2. Të njoftohet me këtë vendim dhe opinionet bashkëlidhur, kandidatet e mësipërm dhe Prokurori i Përgjithshëm.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 30.11.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR

Alfred Balla

